

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Gani Avdiu e Zenel Leku – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.RR. nga fshati ..., komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.S.K. nga Prizreni, kundër të paditurit A.SH. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.R.B. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesave të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.945/09, të datës 19.06.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 05.11.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesa e paditësit B.RR. nga fshati Kobaj, komuna e Prizrenit dhe ankesa e të paditurit A.SH. nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.945/09, i datës 19.06.2014, **VËRTETOHET**, përveç pjesës për llogaritjen e kamatës, e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 19.06.2014, e deri në pagesën definitive.

## **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.945/09, të datës 19.06.2014, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit B.RR. nga fshati ..., komuna e Prizrenit dhe e ka obliguar të paditurin A.SH. nga Prizreni, që në emër të dëmit (jomaterial) t’ia kompensojë paditësit shumat si në vijim: për dhimbje fizike (trupore) shumë prej 1,500.00 €, për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit, shumë prej 300.00 €, respektivisht shumë e përgjithshme prej 1,800.00 €, me kamatë ligjore 3.5 %, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit (19.06.2014), e deri te pagesa definitive. Në pikën II të dispozitivit e ka obliguar të paditurin që shumë nga pika I e dispozitivit si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 285.20 €, t’ia paguaj paditësit në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Në pikën III të dispozitivit pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësit B.RR., mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën pikën I të këtij aktgjykimi, e deri në shumë e kërkuar prej 15,00.00 €, e ka refuzuar si të pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e të autorizuarit të paditësit B.RR. dhe konform nenit 195 pika. 1 nën (e), ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar ose që ta aprovoj ankesën dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim.

Kundër këtij aktgjykimi edhe i padituri përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktgjykimin e shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe të njëjtin ta detyroj që t'ia kompensoj të paditurit shpenzimet procedurale, ose që në pjesën e kundërshtuar me këtë ankesë aktgjykimin në fjalë ta prishë dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim në këtë pjesë.

Përgjigje në ankesën e të paditurit ka parashtruar paditësi me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e të autorizuarit të të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat e paditësit dhe të paditurit janë të **pabazuara**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.RR., me datën 26.11.2009, asokohe në Gjykatën Komunale në Prizren ka paraqitur padi për kompensim të dëmit jomaterial, kundër të paditurit A.SH., me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.945/09, të datës 19.06.2014, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjyqimit ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi në ditën kritike është qëlluar nga i padituri me armë dhe i njëjti ka pësuar lëndim trupor. Gjykata ka theksuar se paditësi në rastin e lëndimit ka pësuar lëndim të rëndë trupor për shkak të qarjes së indeve të buta dhe muskujve të këtij regjioni dhe ndalimit të kësaj copëze metalike me dimensione prej 12 me 6 ml, në të ngritura kockore të anës së majtë të mjekrës, pasi që ka pësuar plagë nga arma e zjarrit në regjionin e anës së majtë të mjekrës, ku aktualisht ekziston trupi i huaj metalik. Gjithashtu gjykata ka theksuar se në momentin e lëndimeve trupore paditësi ka përjetuar dhimbje fizike si në vijim: a). me intensitet posaçërisht të rëndë 30 min., b). me intensitet të rëndë 12 orë., c). me intensitet të mesëm 10 ditë dhe d). me intensitet të ulët ka vazhdimisht edhe në ditët e sotme e që më të shprehura janë gjatë mbrëmjes dhe varësisht prej ndryshimeve klimatike. Më tutje ka theksuar se dëmtimet e lartcekura nuk kanë ndikuar në zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ndërsa shëmtimi ekziston në shkallë të lehtë për shkak të vrahës me gjatësi prej 0.5 x 0.5 cm, e cila është shkaktuar nga copëza metalike e armës së zjarrit. Lidhur

me bazën juridike ka vendosur në bazë të dispozitave të nenit 186 dhe 277 paragrafi 1 të LMD-së dhe nenit 143 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitura nga paditësi dhe i padituri, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk janë pranuar si të themelta për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare si për bazën juridike të kërkesëpadsisë ashtu edhe për lartësinë e saj. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadsisë është i drejtë dhe i bazuar. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë së paditëses.

Me nenin 154 al.1 të Ligjit mbi Marëdhëniet e Detyrimeve (LMD), të zbatueshëm për këtë rast, është paraparë se **“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftëse nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**. Në rastin konkret nuk ka qenë kontestues fakti se i padituri përmes veprës penale për shkak të së cilës edhe i është shqiptuar dënimi përkatës, i ka shkaktuar dëm këtu paditësit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore (edhe pse pa pasoja për jetë), më saktësisht të përshkruara sikurse në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe se si pasojë e këtyre lëndimeve ai është privuar nga të mirat të cilat i ka pasur para se të jetë lënduar nga i padituri, për çka atij edhe i ka takuar shpërblimi i dëmit jomaterial, sikurse ka vendosur gjykata e shkallës së parë, duke gjykuar se shumat e vendosura sikurse në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë të drejta dhe në proporcion me shkallën e të dëmit të pësuar të paditësit. Arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë, duke gjetur se i njëjti është arsyetuar mirë dhe në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në procedurë dhe duke i respektuar rregullat procedurale. Mbi bazën e të lartcekurave gjykata gjen se nuk qendrojnë pretendimet e paditësit për mos vërtetim të plotë apo të drejtë të gjendjes faktike, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku përmes ekspertizës mjeko – ligjore, e ka konstatuar shkallën e lëndimit dhe shkallën shëmtimit, ekspertizë kjo e cila nuk është kontestuar as nga vetë ai, e as nga i autorizuari i tij, ku mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar, e duke repsketuar rregullat procedurale ka vendosur sikurse në aktgjykimin e atakuar.

Nuk qendrojnë as pretendimet anikmore të të paditurit sepse në rastin konkret, e nga sa u tha më lartë, baza juridike e kërkesëpadsisë në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese, por kontestuese është paraqitur të jetë shkalla e lëndimit të paditësit, ku në bazë të ekspertizës së bërë mjeko - ligjore në këtë procedurë, është provuar se paditësi ka pësuar lëndime të cilat në

bazë të ekspertit dr.XH.S. – ortoped – traumatolog, konsiderohen si lëndime të rënda trupore (edhe pse pa pasoja për jetë). Me nenin 14 të LPK parashihet se “*në procedurën kontestimore gjykata në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”. Për gjykatën e shkallës së dytë, ka qenë krucial fakti se i padituri përmes veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, i ka shkaktuar lëndim trupor këtu paditësit, në ndërkohë që për shkallën e lëndimit dhe pasojat nga ky lëndim, është zhvilluar procedura civile kontestimore përgjatë të cilës janë provuar faktet përkatëse mbi bazën e të cilave pastaj edhe ka vendosur gjykata e shkallës së parë. Për gjykatën e shkallës së dytë, është irelevant fakti se i padituri në procedurën penale është shpallur fajtor dhe dënuar, mes tjerave, për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, ngase edhe pse në atë procedurë është konstatuar vepra penale e lëndimit të lehtë trupor (të cilën vepër ai e kishte pranuar në atë procedurë), ku shkalla e lëndimit të konstatuar në atë procedurë ka qenë determinuese edhe për njërën prej veprave penale të tij, megjithatë gjykata në procedurën penale nuk kishte vendosur për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit, tani këtu paditësit (për më tepër që në aktgjykimin penal i njëjti as që është udhëzuar që për realizimin e kërkesës eventuale pasurore mund të inicoj kontest civil). Meqenëse në atë procedurë vetëm është vendosur për përgjegjësinë penale të këtu të paditurit për çka i njëjti është shpallur fajtor për veprat penale sikurse u cek më lartë, paditësi për kërkesën e tij pasurore juridike, i është drejtuar pastaj gjykatës në këtë procedurë civile, me padi për shpërblimin e dëmit jo material, ku pas administrimit të provave, e sidomos marrjes së ekspertizës nga eksperti i lëmisë përkatëse, është provuar edhe natyra e lëndimit, e edhe shkalla e shëmtimit, të cilën e ekspertizë nuk e ka kontestuar paditësi, në ndërkohë që as nga i padituri nuk ka pasur ndonjë propozim për ekspertizë tjetër apo superekspertizë, pasi që kualifikimi i lëndimit nga eksperti kompetent mjeko - ligjor i lëmisë ortopedike dhe traumatologjike, ka rezultuar me gjendje tjetër të lëndimit të pësuar të paditësit nga i padituri. Mbi bazën e këtyre rrethanave dhe duke marrë për bazë arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë gjen se vendimi i kësaj të fundit është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveç për pjesën e kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket aplikimit të kamatës dhe kohës së llogaritjes, duke e gjykuar kamatën sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD së zbatueshme për këtë rast.

Lidhur me vendosjen për shpenzimet e procedurës Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosë edhe për shpenzimet e procedurës, duke i aplikuar dispozitat e nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të

dispozitive nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.3090/14, me datën 05.11.2018**

**Kryetari i kolegjit – Gjyqtari,  
Valon Totaj**